



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 376/2022

**në lidhje me zvarritjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega
në Istog lidhur me lëndën C. nr. 5/2021**

Drejtuar: Z. Shemsedin Haxhijaj, gjyqtar mbikëqyrës
Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog

Prishtinë, më 4 dhjetor 2024

Qëllimi i raportit

1. Ky raport ka për qëllim t'ia tërheqë vëmendjen Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog (GjThPe) lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për ta shqyrtuar dhe për të vendosur në lëndën C. nr. 5/2021, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën e z. Isuf Demajt (në tekstin e mëtejme: ankuesi) dhe mbështetet në faktet dhe në provat e ankuesit, si dhe në shkresat e lëndës, të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën C. nr. 5/2021.

Baza ligjore

3. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
4. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 8, përcakton: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave.”*

Përmbledhje e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i posedon IAP-ja, mund të përmbliidhen si në vijim:

5. Në bazë të informacioneve të ofruara nga ankuesi vërehej se në GjThPe – Dega në Istog ishte duke u zhvilluar procedura gjyqësore lidhur me lëndën C. nr. 5/2021.
6. Sipas pohimit të ankuesit vërehej se më 11 maj 2021 ai kishte parashtruar padi në GjThPe – Dega në Istog dhe lënda kishte marrë numrin C. nr. 5/2021, e cila kishte të bënte me kompensim dëmi.
7. Më 24 qershor 2022, Institucioni i Avokatit të Popullit kishte pranuar ankesë nga z. Isuf Demaj, parashtruar kundër GjThPe-së – Dega në Istog, për shkak të zvarritjes së procedurës gjyqësore lidhur me lëndën C.nr. 5/2021.
8. Më 18 korrik, më 16 dhjetor 2022 dhe më 15 qershor 2023, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit e kishte kontaktuar gjyqtarin mbikëqyrës, i cili ishte edhe gjyqtar i çështjes, dhe kishte kërkuar informata lidhur me çështjen e ankuesit dhe nga ai ishte njoftuar se lënda do të shqyrtohej sipas radhës së arritjes në gjykatë.
9. Më 27 dhjetor 2023, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, përmes adresës elektronike e kishte kontaktuar gjyqtarin e rastit dhe kishte kërkuar informata lidhur me çështjen e ankuesit.
10. Më 29 dhjetor 2023, gjyqtari i çështjes kishte kthyer përgjigje dhe e kishte njoftuar përfaqësuesen e Avokatit të Popullit se lënda në fjalë do trajtohej sipas radhës së arritjes në gjykatë.
11. Më 15 korrik 2024, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit e kishte kontaktuar gjyqtarin e çështjes dhe kishte kërkuar informacione për çështjen e ankuesit dhe nga ai ishte njoftuar se gjykata akoma nuk kishte vendosur lidhur me lëndën në fjalë.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

12. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton: *“Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...]”*
13. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përcaktohet me nenin 31.1 të Kushtetutës: *“Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
14. Po ashtu mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e përcaktuar me nenin 54 të Kushtetutës, parasheh: *“Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”*
15. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është dokument ligjor drejtpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.¹ Ndërsa paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së garanton: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.”*
16. Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, në nenin 7, paragrafi 2, përcakton: *“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë, në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.”*
17. Ndërsa neni 7, paragrafi 5, i Ligjit për Gjykatat përcakton: *“Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.”*

Analiza ligjore

18. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ).
19. GjEDNJ-ja, në disa raste, ka theksuar se e drejta e palës që për çështjen e saj të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
20. Avokati i Popullit gjen se praktika e GjEDNJ-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih mes të tjerash Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005, dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

21. Avokati i Popullit, lidhur me mosinformimin e palës për fazën në të cilën gjendet lënda e vet, gjen se sipas vendimeve të GjEDNj-së, një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).
22. Sipas praktikës së gjykatës (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga 11 maji 2021, kur ankuesi kishte parashtruar padi në GjThPe – Dega në Istog, e deri në ditën e publikimit të këtij raporti.
23. Njëkohësisht, mungesa e mjeteve efektive për trajtimin e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, e drejtë kjo e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës [E drejta për zgjidhje efektive], i cili përcakton: “Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.”
24. Më tej neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht t’i mbrojtë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ, që bën të mundur që ai/ajo t’i gëzojë të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrorjë këtë ankesë te një autoritet vendor. Kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih Aktgjykimin *Kudla kundër Polonisë*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv te një autoritet vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Pasi rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
25. Për sa i përket zbatimit të nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih Aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).
26. Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe ta lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).
27. Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të kishin qenë në gjendje ta parandalonin

shkeljen e pohuar apo mosvazhdimin e saj, ose ta ofronin përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).

28. Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor, përmes të cilit ankuesi do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo të kompensimit.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

29. Avokati i Popullit rikujton se sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore, e që në rastin konkret është data 11 maj 2021, dhe konstaton se zvarritja e tillë, pa vendim përfundimtar, shkel:

- të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuara dhe të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së;
- të drejtën për mjete efektive juridike, e mbrojtur me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së;
- të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

30. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, në bazë të nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 16, paragrafi 8, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës,

i

REKOMANDON

Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog:

- Pa vonesa të mëtejme t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për ta shqyrtuar dhe për të vendosur për lëndën C. nr. 5/2021.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit